


# Letër familjes

I dashur nxënës, të dashur anëtarë të familjes,

Gjatë vitit të kaluar e kemi parë matematikën të ilustruar në situata nga më të ndryshmet. Në këtë kapitull do të shohim më nga afër se si të punojmë me të dhënat, duke përfshirë këtu edhe të dhëna nga jeta reale. Do të përdorim tabela për t'i organizuar të dhënat, për të kërkuar modelet dhe për të nxjerrë përfundime. Do të përdorim mjete pamore, duke përfshirë këtu edhe një hartë që paraqet ecurinë e një epidemie të dikurshme të kolerës në Londër. Nëpërmjet hartës, do të mbledhim prova për të caktuar burimin e epidemisë.



Copyright 1991 National Geographic Society Publications. Art

Gjatë gjysmës së dytë kapitullit, do të përdorim *modele matematike*. Për shembull, do të përdorim ekuacione për të modeluar rritjen e popullsisë dhe për të bërë parashikime. Gjithashtu do të analizojmë një biznes duke përdorur tabela dhe një popullatë model për të parë si numri i mëngjërashëve mund të ndryshojë nga një brez në tjetrin.

## Çfarë mund të bëni në shtëpi?

Kërkojini nxënësit t'ju tregojë për epideminë e kolerës dhe për situata të tjera të cilat ai po mëson si t'i analizojë. Gjithashtu ju mund të lexoni gazetën së bashku, për të kërkuar rregullsi: si për shembull, për të parë nëse ka rregullsi në temperaturat e paraqitura në hartën e motit.

